

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Votimi - Pagat e magjistratëve/ Rama miraton sa 0.2% e pagës së Presidentit,
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917485/pagat-e-magjistrateve-rama-miraton-sa-0-02-e-pages-se-presidentit-injoron-sistemin-gjyqesor-pd-puc-kushtetues/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:52:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 06:37:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e6f244efa47fd92da23367b3961be89f3f98190e669ae5443823e7fa2b4670bd
TEKSTI	80046fa61e88cb53f85fdf2b14bd02735c95c336c9ddb9955c82eca3b115d4db
PAMJA	741bade9d5f609a7be7d58cd929c6ede31db6adc3461acbb92a9f5ec0d36b670

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	46df0ae35fd5aad043dc60bedb685a592a9245a1584daa0ddf9b7e1d0933423e
E MËPARSHMJA	307f758d836fefaff43b950f44c2172d16d8d361feb544b7cbff8a1246b793ae
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/46df0ae35fd5aad043dc60bedb685a592a9245a1584daa0ddf9b7e1d0933423e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi




Foto nga votimi për pr. ligjin për pagat e magjistratëve



Pagat e magjistratëve/ Rama miraton sa 0.2% e pagës së Presidentit, 'injoron' sistemin gjyqësor! PD: Puç kushtetues

08:37, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Maxhoranca miratoi e vetme pr. ligjin për statusin e gjyqtarit i cili parashikon një rritje të pagës referuese me rreth 8,500 lekë sa 0.2% e pagës së Presidentit. Një rritje qesharake, disa herë më pak se paga baza referuese prej 222 mijë lekësh dhe 14 mijë lekë shtesë për kualifikimin që kishte përcaktuar Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të afatit nga Gjykata Kushtetuese.

Pr. ligji i cili u hodh për votim në orët e vona të natës kaloi me 84 vota pro të maxhorancës, ndërsa 24 deputetë të PD votuan kundër. Po kështu qeveria ka përlogaritur edhe 1.5 miliardë lekë detyrime të prapambetura nga prilli 2023, të cilat do të shlyhen me kështu brenda dy viteve.

PD kundër: Puç kushtetues

Partia Demokratike kishte kërkuar heqjen nga rendi i ditës të draftit të PS-së për pagat e magjistratëve. Kreu i grupit parlamentar të PD-së Gazment Bardhi theksoi paraditen e djeshme në Kuvend se drafti i mbërritur në seancë nuk ishte ai i konsultuar me institucionet e drejtësisë çka është një tjetër shkelje e Kushtetutës nga ana e mazhorancës.

Gjatë punimeve të pralamentit pasdite, Bardhi deklaroi votën kundër të PD-së duke e cilësuar "puç kushtetues" atë që po ndodh. Bardhi theksoi se mazhoranca po shpërfill për herë të tretë vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe po cenon garancitë financiare të gjyqtarëve e prokurorëve pasi formula e propozuar nuk përbush standardet e vendosura nga Kushtetuesja



"Projektligji që po diskutojmë sot nuk ka të bëjë as vetëm me gjyqësorin, as vetëm me legjislativin dhe as vetëm me ekzekutivin. Ka të bëjë me shtetin shqiptar, ka të bëjë me sistemin institucional dhe kushtetues të Republikës së Shqipërisë. Ju nuk keni vendosur të sfidoni gjyqësorin, por të sfidoni shtetin shqiptar, të sfidoni rendin kushtetues në vend. Shkurt, keni vendosur të vazhdoni një puç kushtetues të nisur që prej vitit 2017 lidhur me këtë çështje."

më të lexuarat



'Akuza të stisura politikisht', Saiti: Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës



Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Taçi ishte anëtar kyç



Takimi sekret i DEA-s me vendet e Amerikës Latine/ Si po i damkos shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës



A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...



By Pass i Elbasanit/ 'Karakçi në rrugën e Ballukut', Himci: S'dihet kur do përfundojë, tenderat po vidhen



'Taçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

"Gjyqtarët dhe prokurorët nuk po kërkojnë rritjen e pagës së tyre. Nëse do të kërkonin një rritje të re të pagës, nuk do të kishin as mbështetjen e grupit parlamentar të Partisë Demokratike. E vërteta është se prokurorët dhe gjyqtarët e Republikës po kërkojnë të marrin pagën që ky Kuvend ua përcaktoi në vitin 2016", tha Bardhi.

Ndërkohë kreu i grupit parlamentar të PS-së Taulant Balla gjatë seancës së paradites u shpreh i vendosur se pr/ligji do kalojë ashtu siç ka ardhur, madje i bëri thirrje presidentit ta miratojë pa humbur kohë.

Beteja vijon

Pritet që pr/ligji i miratuar të mos ndalë përplasjen me sistemin e drejtësisë. Më 16 shtator Gjykata e Lartë i kërkoi Parlamentit që projektligji të mos votohet duke paralajmëruar se nëse ndodh nuk do të ketë tërheqje,

"Kuvendi miraton ligje, por nuk mund të relativizojë Kushtetutën. Mund të zgjedhë zgjidhjen ligjore, por nuk mund të anashkalojë një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese. Mund të ftojë gjyqësorin për konsultim, por nuk mund ta përdorë praninë e tij për të legjitimuar një konsultim që realisht nuk ka ndodhur.

Gjykata e Lartë dhe gjyqësori nuk kërkojnë privilegje. Kërkojnë respektimin e Kushtetutës, të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të dinjitetit të një pushteti të pavarur. Për këto nuk ka dhe nuk do të ketë tërheqje," thuhej në një deklaratë të Gjykatës së Lartë.

Po dje reagoi Shoqata Evropiane e Gjyqtarëve e cila deklaroi se mosrespektimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese është i barasvlershëm me shkeljen e vetë Kushtetutës dhe të shtetit të së drejtës.

Si nisi përplasia

Gjykata Kushtetuese shfuqizoi në shkurt të këtij viti si të papajtueshme me Kushtetutën formulën e mëparshme të miratuar nga Kuvendi për pagat e magjistratëve dhe i la ligjvënësit afat deri më 31 korrik për miratimin e një formule të re.

Vendimi parashikonte gjithashtu një mekanizëm zhblokuës, sipas të cilit formula e re e pagave do të përcaktohej nga vetë organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë në rast se Kuvendi nuk vepronte brenda afatit.

Pas përfundimit të afatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcaktuan një pagë bazë referuese prej 222 mijë lekësh dhe 14 mijë lekë shtesë për kualifikimin. Këshillat vendosën gjithashtu kompensimin e asaj që e konsideruan "ulje të fshehur" të pagave nga ligji i mëparshëm, për periudhën nga prilli 2023 deri më 31 korrik 2026.

Ministria e Financave refuzoi ta zbatonte këtë përllogaritje, ndërsa magjistratët iu drejtuan SPAK me kallëzim penal dhe Gjykatës Administrative me padi. Gjykata Administrative vendosi në favor të pagesës së gjyqtarëve dhe prokurorëve sipas formulës së përcaktuar nga këshillat.

Përplasia mes institucioneve të drejtësisë dhe shumicës parlamentare pritet të vijojë pasi pr/ligji u miratua rreth orës 01:00 të 18 shtatorit.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Ftesa për magjistratët/ Blushi-Ramës: Pse s'i thirre para 31 korrikut, kur skadonte afati i GJK?



Pagat e magjistratëve, Meta: Rama delirant, nuk njeh Gjykatën Kushtetuese as parimin e shtetit të së drejtës



SYRI TV/ Rama shkon në Kuvend në mesnatë, nuk jep llogari për Ron Yeffet

Ligji për statusin e magjistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...

'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

TË NGJASHME



U votua gjatë natës dhe u dekretua në



Vendimi në Hagë dhe retë e zeza mbi



Gazeta spanjolle: Thellohet skandali i



Garo: Nufi bëri trafik armësh në

mëngjes nga presidenti, botohet në
Fletoren Zyrtare formula e pagave të
magjistratëve



Emaili/ Gjykata e Londrës i tërheq
veshin Enea Karakaçit për konfliktin
në Aeroportin e Vlorës

Pavarësinë e Kosovës!



KiE ngre alarmin: Në spitalin e burgut
dhe të Shënkollit trajtim çnjerëzor dhe
poshtëruës! Zhgënjyese nga qeveria

AKSHI-t të Ramës, një i arrestuar
kishte kështjellë, një shef policie i
mbronte



KiE ngre alarmin: Burgu i Shënkollit
me 200 shtretër, ka 469 të burgosur!
Me të sëmurët edhe vrasës me pagesë

shkelje të ligjeve të NATO-s dhe BE-
së, të dorëhiqet bashkë me Ramën

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.